



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:058908

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766240

P.nr.69/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh. B. nga fsh. H. i V. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.515/24 të dt.20.02.2024, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 28.05.2024, në prani të prokurorit të shtetit Menduhi Kastrati, të pandehurit dhe të dëmtuarit KEDS, të cilin e përfaqëson Trendelina Kryeziu, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

Sh. B., i lindur me ..., në P., nga fshati H. i V., ku edhe tani jeton, nga i ati B., e ëma F., mbiemri i vajzërisë G., i gjendje së dobët ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 11.11.2023 në shtëpinë tij në fshatin H. i V. Komuna L., i pandehuri, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka vjedhur energjinë elektrike duke e marr dhe shfrytëzuar pa autorizim nga KEDS si furnizues i autorizuar, në atë mënyrë që në njësinë elektrik nr...., ka bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse ku njehsori ka qenë i shkyçur nga distanca, por i njëjti është kyçur direkt në rrejt pa matje, dhe si rrjedhojë energjia elektrike e shpenzuar nuk është matur në njësinë, ashtu që të dëmtuarës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS, Sh. a - Distrikti në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej **498.59 euro**,

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Detyrohet i pandehuri që të dënuarës KEDS-së Distrikti në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar material në lartësi prej 498.59-€, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumë prej 20-€, si dhe shumë nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.515/24 të dt.20.02.2024, e ka akuzuar të pandehurit Sh. B. nga fsh. H. i V. K. L., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së, duke i propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe i bashkangjitet ndjekjes penale si dhe parashtrohet kërkesës pasurore-juridike në lartësi prej 498.59 euro.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se është i gjendjes së rënd ekonomike, mbajtës i familjes 9 antarshe dhe mban familjen me punë krahu, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit sjellje të tilla dhe e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është mbajtës i familjes 9 antarshe dhe i gjendjes së rënd ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e ulët të përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ në emër të paushallit gjyqësor u caktua në bazë të ndërlikshmërisë së rastit,

ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua nën 462 të KPPK-së, dhe gjykata e detyroi të pandehurin që të dëmtuarës KEDS-se Distrikti Ferizaj, t'ia kompenzoi dëmin material të shkaktuar me kryerjen e veprës penale me arsyetimin se nga provat që gjinden në shkresat e lëndës fatura për rikthimin e humbjeve, është vërtetuar lartësia e dëmit material të shkaktuar nga përdorimi i mjeteve elektrike të cilat janë identifikuar me rastin e kontrollës së relizuar nga personat e autorizuar të të dëmtuarës.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.69/24 dt.28.05.2024

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:058908
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05766240